

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektsh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Oficeri i Kontrollit te Cilesise

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Oficeri i Kontrollit te Cilesise ka përgjegjësi për implementimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilesise së projektit si edhe sigurohet që instalimet në kantier të jenë në përputhje me Politikat e Cilesise së kompanisë bashkë me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe kërkesat e klientit.

❖ DETYRAT KRYESORE

- Zbaton Planin e Cilesise dhe Planet e Kontrollit dhe Inspektimit në Kantier;
- Paraqet keshilla për inspektim grupit të Zbatimit të Projektit mbi çështje të cilesise;
- Vendos dhe mirëmban mardhenie të mira me Klientin dhe oficeret e tyre;
- Kujdeset që aktivitetet ndërtimore të nenkontraktoreve të kryehen në cilesine e duhur në kohën e duhur;
- Sigurohet që të gjitha dokumentat në lidhje me projektin janë të azhurnuara dhe të disponueshme për inspektim;
- Identifikon problematikat në kantier për sa i përket cilesise në materiale dhe puntori;
- Pret, inspekton materialet e ardhura në kantier dhe sigurohet që ato të jenë sipas specifikimeve teknike dhe atyre të përzgjedhur nga kompania;
- Zhvillon aktivitetet sipas planeve të inspektimit (pritje, në proces dhe në fazë finale);
- Raporton në baze ditore për aktivitetet e cilesise në kantier;
- Asiston dhe drejton investigim në terren në prani dhe të Kordinatorit të cilesise;
- Kordinon, kontrollon dhe shpërndan të gjithë dokumentacionin të cilesise;
- Monitoron të gjitha aktivitetet e cilesise në projekt;
- Asiston në të gjitha auditet e brendshme dhe të jashtme të kompanisë;
- Asiston në mbledhjet e cilesise që organizojnë klientet (në kantier);
- Merret me korrespondencën hyrje/dalje të cilesise përfshirë dhe shpërndarjen e Kërkesave për Inspektim;
- Raporton problematikat me kthimet dhe mospranimet dhe ndjek NCR të hapura mbi materialet;
- Asiston në përgatitjen e të gjithë dokumentacionit përmbylles të projektit;
- Ndjek Raportet e Jo Konformitetet;
- Monitoron dhe bashkëvepron me eprorin;
- Zbaton dhe mirëmban, monitoron dhe ndjek, rregjistrat duke përfshirë këtu Inspektimin e Materialeve, Jo-Konformiteteve/Masave Korrigjuese, etj.
- Përgatit raportin e progresit javor/mujor/vjetor.
- Kordinon dhe ndjek testimet në kantier

❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Inxhinier Ndertimi

Gjuhe te huaja: Njohuri te mira te gjuhes angleze;

Njohuri kompjuterike: Msc Office, Autocad;

Eksperienca e kerkuar: Mbi 3 vite experience pune ne pozicion te ngjashem;

Te gjithë te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 10 Gusht 2026, ora 17:00**.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrotjen e të dhënave personale